



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORI I PËRGJITHSHËM**

**U D H Ë Z I M Nr. 1
Datë 29. 01. 2007**

**PËR
ZBATIMIN E LIGJIT "PËR DHËNIE AMNISTIE"**

Me synim, përjashtimin nga ndjekja penale në hetimet paraprake dhe në gjykim, si dhe mosekzekutimin e vendimeve penale ndaj personave që përfitojnë nga kjo amnisti;

Në mbështetje, të nenit 24/4 e vijues të K. Pr. Penale, të nenit 8 pika 2 të ligjit Nr. 8737, datë 12. 02. 2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhenë nenet 6 e vijues të ligjit Nr. 9678, datë 13. 01. 2007 "Për dhënie Amnistie",

U D H Ë Z O J:

1. Të vendoset pushimi i ndjekjes penale për çështjet në hetim, për çështjet e pashqyrtuara nga gjykatat, si dhe të vendoset mosfillimi i procedimit për kallëzimet që ndodhen në këto organe dhe në organet e rendit publik, pavarësisht nga data e regjistrimit të tyre, për veprat penale të kryera deri në datën 31 dhjetor 2006, për të cilat Kodi Penal parashikon një dënim me burgim deri në 2 vjet ose çdo lloj dënimi tjetër më të lehtë.

1.1 Kjo zgjidhje ligjore t'iu jepet edhe procedimeve penale të pezulluara për vepra penale që përfitojnë nga amnistia, që ndodhen në Prokurori ose në shërbimet e Policisë Gjyqësore të çdo strukture, duke vendosur më parë rifillimin e hetimeve të pezulluara, mbështetur në nenin 326 pika 3 e K. Pr. Penale.

2. Vendimet e mosfillimit të procedimeve dhe të pushimit të çështjeve t'i njoftohen të interesuarve, për t'iu garantuar të drejtën ligjore të ankimit në gjykatë.

Ata që kanë pësuar dëm material nga vepra penale që amnistohet, të sqarohen për të drejtën e ngritjes së padisë civile në gjykatë.

3. Në rastet, kur nga të dhënat që ndodhen në aktet e kallëzimit, ngjarjes ose ankimit apo në aktet e hetimeve paraprake në ndjekje, nuk mund të konkludohet për kualifikimin ligjor - nëse ndodheni ose jo para veprës penale të amnistuar - duhet të kryhen hetime të nevojshme, për të provuar faktin dhe pasi të bëhet kualifikimi i drejtë i veprës penale, të vendoset për mënyrën e zgjidhjes ligjore të përfundimit të çështjes.

4. Për akuzat e ngritura dhe të pashqyrtuara nga gjykata, për vepra penale të kryera deri në datën 31 dhjetor 2006, për të cilat Kodi Penal, Kodi Penal Ushtarak ose dispozita penale në ligje të veçanta parashikojnë dënim me burgim deri në 2 vjet ose çdo lloj dënimi tjetër më të lehtë, prokurorët sipas juridiksionit dhe kompetentes, të cilët marrin pjesë në shqyrtimin gjyqësor të këtyre çështjeve, të kërkojnë nga gjykata, pushimin e çështjeve, mbështetur në nenin 387 e vijues të K.Pr.Penale dhe neni 5 i ligjit "Për dhënie amnistie".

5. Në fazën e ekzekutimit të vendimeve penale, prokurorët të verifikojnë urdhrat e tyre të ekzekutimit të pazbatuar, për të gjithë kategoritë e personave dhe llojet e dënimit që përfitojnë sipas nenit 1 pikat 1 e 2 dhe nenin 2 të këtij ligji/duke shfuqizuar urdhrat e ekzekutimit të tyre, bazuar në nenin 463/1 të K. Pr. Penale, nenet 12 e 28 të ligjit "Për ekzekutimin e vendimeve penale" dhe në këtë amnisti, duke kryer dhe azhurnimet e duhura me shërbimet e policisë gjyqësore të ngarkuara/urdhëruara me ekzekutimin e tyre.

6. Drejtuesit e Prokurorive të shkallës së parë dhe të Apelit, brenda datës 28 shkurt 2007, të informojnë Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm, për numrin e personave dhe të procedimeve të mosfilluara, çështjeve të pushuara në hetim dhe në gjykim, si dhe për numrin e personave të dënuar në fazën e ekzekutimit të vendimeve penale, që kanë përfituar nga kjo amnisti.

7. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen prokurorët e të gjithë niveleve, ndërsa për të ndjekur dhe kontrolluar zbatimin e tij ngarkohen drejtuesit e Prokurorive dhe të strukturës së Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm.

8. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë, ndërsa zbatimi i tij, për efekt të hyrjes në fuqi të ligjit, fillon me datë 01. 02. 2007.

PROKURORI I PËRGJITHSHEM

THEODHORI SOLLAKU

Konc&Kom K.L
29. 01. 07

